



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/24  
Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12, paragrafin 1.11, dhe nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, si dhe në zbatim të nenit 4, 33, 41 dhe nenit 47 të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/11 datë 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, si dhe në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese nr. KO54/20, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:


**V E N D I M**

1. Autorizohet Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë që të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të përhapjes së sëmundjes COVID-19, në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse.
2. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë pas rekomandimeve të njësive përkatëse profesionale dhe në konsultim me Komunitatet respektive do ta përcaktojë orarin e lëvizjes/ndalimit të qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve, duke pasur mundësinë të bëjë përjashtime edhe të orareve të kufizimeve të përcaktuara në pikën 1.1 të Vendimit nr. 02/17 të datës 27.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Me qëllim të racionalizimit të kohës në procesin e marrjes së vendimeve, në funksion të parandalimit dhe luftimit të përhapjes së epidemisë së sëmundjes COVID-19, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë